



Datë: 28.04.2025
Numër Protokolli: 2836/2025

A.nr.530/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.530/2025 të datës 24.03.2025, të parashtruar nga ankuesi L.K., kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.530/2025, të datës 24.03.2025, të parashtruar nga ankuesi, L.K.

A r s y e t i m

Ankuesi, L.K. (*më tej referuar vetëm* Ankuesi), kandidat për pranim sipas Konkursit me numër Reference RN0016310, të shpallur më datë 13.01.2025 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për pozitën e punës “*Drejtor i Departamentit të Mbrojtjes së Mjedisit*”, më datë 24.03.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1915/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.530/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me refuzimin e aplikacionit të tij nga procedura e rekrutimit.

Tutje, ankuesi më datë 10.04.2025, përmes shkresës me numër protokolli 2370/2025, për arsye personale është tërhequr nga ankesa A.nr.530/2025 e datës 24.03.2025.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 10.04.2025, të ankuesit për tërheqje nga ankesa A.nr.530/2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.530/2025 të datës 24.03.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.530/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit L.K.;
- Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.